



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

T.+355-4-2281662 E. commissions@cec.org.al, www.cec.org.al



DREJTORIA E KOMISIONEVE ZGJEDHORE, TRAJNIMIT DHE EDUKIMIT TË ZGJEDHËSVE

Relacion

Për projektvendimin "Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me Vendimin Nr. 18, datë 01.02.2019, dhe Vendimin nr. 19, datë 01.02.2019, ka caktuar partitë politike, që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), që do të ngrihen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Në bazë të përcaktimeve të akteve sipërcituar, Partia Socialiste e Shqipërisë, do të paraqesë tre kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve, dy kandidatura si parti eparë e shumicës parlamentare dhe kandidatura e tretë për të realizuar barazpeshimin politik shumicë-opozitë në përbërjen e KZAZ-ve. Partia e parë dhe e dytë e opozitës parlamentare të cilat do të propozojnë anëtarë të KZAZ-ve, janë Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste për. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve me numër çift do të propozohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve me numër tek do të propozohet nga Partia Demokratike.

Partia Socialiste e Shqipërisë ka paraqitur brenda afatit ligjor, shkresa nr. 1499, datë 18.03.2019, propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim nuk kanë paraqitur propozime për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve.

Kandidatët e propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ, plotësojnë kërkesat e nenit 29, nenit 30, dhe nenit 31 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, propozimet përmbushin kriterin e përcaktuar në nenin 29, pika 1, germa "ç" të Kodit Zgjedhor, pasi 37% e kandidatëve të propozuara janë gra.

Ana TENOLLI-

Drejtorja e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve

Dëshira PASKO-

Drejtorja Juridike

Ylli MERKAJ-

Sekretari i Përgjithshëm